



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 qershor 2017
Nr. ref.:RK 1085/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI148/16

Parashtrues

Mitat Qovanaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në
Prizren, CP. nr. 1976/13, të 22 majit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Mitat Qovanaj, me banim në Prizren (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Egzon Qovanaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, CP. nr. 1976/13, të 22 majit 2014 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës, e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe nenin 54 të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë në Gjykatë.
7. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.
8. Më 6 mars 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai informata nëse ka parashtruar ankesë kundër Aktvendimit CP. nr. 1976/13, të 29 gushtit 2014. Një kopje e kërkesës i është dërguar edhe Gjykatës Themelore në Prizren.
9. Më 16 mars 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument, duke deklaruar se nuk ka parashtruar ankesë kundër Aktvendimit CP. nr. 1976/13, të 29 gushtit 2014.
10. Më 3 maj 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës, i autorizuar nga babai i tij, parashtroi padi në Gjykatën e Qarkut në Prizren, duke kërkuar konfirmimin e pronësisë dhe kompensimin si rezultat i eksproprijimit të pronës në rajonin e Vërmicës.
12. Më 10 qershor 1985, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Cp. nr. 292/83) konfirmoi pronësinë mbi parcelat e shpronësuara dhe e obligoi Sekretariatën Federal për Hidro-ekonomi "Drini i Bardhë" (në tekstin e mëtejme: i padituri) që t'i paguajë parashtruesit të kërkesës një shumë të caktuar të hollave si kompensim. Kundër këtij vendimi, i padituri parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme.
13. Më 24 dhjetor 1985, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzoi ankesën e të paditurit si të pabazuar, dhe vërtetoi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Qarkut, të 10 qershorit 1985.
14. Më 19 shtator 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, C. nr. 292/83, të 10 qershorit 1985, në Gjykatën e Qarkut në Prizren.
15. Më 24 mars 2014, Gjykata Themelore (Aktvendimi C. nr. 1976/13) e aprovoi kërkesën e parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren të 10 qershorit 1985.
16. Më 8 prill 2014, Komuna e Prizrenit parashtroi prapësim kundër vendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Përveç kësaj, Komuna e Prizrenit arsyetoi kundërshtimin e saj, duke deklaruar se kërkesa për përmbarim ishte dorëzuar pas afatit të përcaktuar me ligj. Parashtruesi i kërkesës nuk parashtroi përgjigje ndaj kundërshtimit të Komunës së Prizrenit.
17. Më 22 maj 2014, Gjykata Themelore (Aktvendimi Cp. nr. 1976/13): I. Aprovoi kundërshtimin e Komunës së Prizrenit si të bazuar; II. Refuzoi kërkesën e parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit të 10 qershorit 1985 si të pabazuar; dhe III. Shfuqizoi Aktvendimin Cp. nr. 1976/13, të 24 marsit 2014 dhe anuloi të gjitha veprimet lidhur me procedurën e përmbarimit.
18. Gjykata Themelore e bazoi vendimin e saj, duke iu referuar dispozitave të ligjeve në fuqi për procedurën e përmbarimit dhe marrëdhëniet e detyrimeve.
19. Gjykata Themelore konstatoi se: *"[...] po ashtu përkitazi me parashkrimin e kërkesave në procedurën e përmbarimit si në rastin konkret edhe në nenin 361 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) që i referohet kërkesave të vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente, thuhet: "Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet,*

madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”.

20. Prandaj, Gjykata Themelore konkludoi se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi propozimin e tij për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të 10 qershorit 1985 pas skadimit të afatit të paraparë me nenin 361, paragrafi 1 i LMD-së.
21. Më 3 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, të 22 majit 2014.
22. Më 29 gusht 2014, Gjykata Themelore (Aktvendimi Cp. nr. 1976/13) hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës, për shkak se ai nuk e kishte paguar taksën e kërkuar gjyqësore.
23. Me aktvendimin e sipërpërmendur të Gjykatës Themelore, të 29 gushtit 2014, ai ishte këshilluar në mënyrë të qartë: *“Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate”.*
24. Bazuar në deklaratën e parashtruesit të kërkesës të dorëzuar në Gjykatë, më 16 mars 2017, parashtruesi i kërkesës nuk kishte parashtruar ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, Cp. nr. 1976/13, të 29 gushtit 2014.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ka pasur shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së, nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 [Mbrojtja e pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe të nenit 54 të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me zgjatjen dhe mospërmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 10 qershorit 1985, është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë.
26. Sa i përket Aktvendimit të Gjykatës Themelore, Cp. nr. 1976/13, të 22 majit 2014, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Sipas praktikës së GJEDNJ-së, çështjet e mospërmbarimit të vendimeve të formës së prerë res judicata paraqesin shkelje të vazhdueshme, sepse një e drejtë e fituar nuk duhet të ngelet vetëm në letër, ose pjesërisht e zbatuar, por duhet të realizohet edhe në praktikë (shih: Aktgjykimi KI129/11 i Gjykatës Kushtetuese, pjesë të cituara nga Gjykata e Strasburgut)”.*
27. Parashtruesi më tej kërkon *“[...] që ta vërtetoj të drejtën time kushtetuese [Neni 46: Mbrojtja e Pronës], dhe të urdhëroj Kuvendin Komunal në Prizren - Drejtorinë për Punë Pronësore Juridike, përmbarimin e Aktgjykimit Cp. nr. 292/83 të datës 10.06.1985, respektivisht kompensimin e ekspropriimit të tokës, në vlerë prej 84.999.10 Euro, me kamatë ligjore 7, 5%, që do të llogaritet prej ditës së depozitimit me datën 11.11.1980, deri në pagimin përfundimtar”.*

28. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon: *“Përfundimisht, kërkoj nga Gjykata Kushtetuese shqyrtimin e kërkesës sipas Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, edhe pse kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit prej 4 muajsh [...]”*

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe të parapara në Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

31. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh që:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”

32. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, me të cilin theksohet që:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit; ose [...]”.

33. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Themelore, CP. nr. 1976/13, të 22 majit 2014. Vendimi i fundit lidhur me çështjen e parashtruesit të kërkesës është Aktvendimi i Gjykatës Themelore, CP. nr. 1976/13, i 29 gushtit 2014, me të cilin ishte hedhur poshtë ankesa e parashtruesit të kërkesës, sepse ai nuk e kishte paguar taksën e kërkuar gjyqësore. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë, më 19 dhjetor 2016.

34. Sa i përket çështjes së afatit kohor për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Sipas praktikës së GJEDNJ-së, çështjet e mospërmbarimit të vendimeve të formës së prerë res judicata paraqesin shkelje të vazhdueshme, sepse një e drejtë e fituar nuk duhet të ngelet vetëm në letër, ose pjesërisht e zbatuar, por duhet të realizohet edhe në praktikë”*.

35. Lidhur me pretendimin e sipërpërmendur të parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet arsyetimit të Gjykatës Themelore, e cila në aktvendimin e saj konkludoi se kërkesa e parashtruesit për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, të 10 qershorit 1985 ishte parashkruar.

36. Për më tepër, Gjykata vëren se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Themelore, të 22 majit 2014, parashtruesi i kërkesës ishte këshilluar në mënyrë të qartë të parashtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit. Nga vendimi pasues i Gjykatës Themelore i 29 gushtit 2014 rezulton, se parashtruesi i kërkesës nuk ka paguar taksën e kërkuar gjyqësore për ankesën e tij.
37. Më pas, më 29 gusht 2014, Gjykata Themelore theksoi se kundër këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës kishte pasur të drejtë të parashtrojë ankesë. Prandaj, parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të ushtrojë ankesë kundër Vendimit të Gjykatës Themelore, të 29 gushtit 2014, por ai nuk e bëri këtë. Prandaj, dështimi i parashtruesit të kërkesës për të parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedurë të mëtejshme, e cila do të mund të adresonte thelbin e pretendimeve të tij.
38. Si përfundim, duke iu referuar faktit se vendimi i kontestuar ishte marrë më 22 maj 2014, ndërsa parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë më 19 dhjetor 2016, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës.
39. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë sigurinë juridike duke siguruar, që kërkesat të cilat dorëzohen në pajtim me Kushtetutën shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme, dhe se vendimet nga e kaluara nuk mund të jenë vazhdimisht të hapura për vlerësim (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 23274/04, GJEDNJ, vendimi i 25 gushtit 2005).
40. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse është e paafatshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 maj 2017, me shumicë votash

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Aliza Rama-Hajrizi